



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GLLOGOCIT PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Glllogocit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Glllogocit (GLL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Glllogocit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Komuna kishte realizuar pagesa dhe regjistruar shpenzime në vlerë 2,341,210€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate, si rezultat i pagesave nga thesari me vendime gjyqësore; dhe
- A1 Obligimet e papaguara janë nënvlerësuar për 112,664€ si rezultat i mos mbajtjes së evidencave të plota dhe të sakta.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Glllogocit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Komuna nuk kishte arritur të realizojë nivelin e kërkuar të inspektimeve të pronave sipas kërkesave ligjore;
- B2 Në tre (3) raste kishte vonesa në lëshimin e lejeve ndertimore;
- B3 Realizimi i kontratës në kundërshtim me sasishtë/peshat e përcaktuara;
- A3 Në pesë (5) raste vonesat në pagesën e faturave ishin nga 32 deri në 62 ditë;
- A4 Në dy (2) raste rialokimi i mjeteve për projekte kapitale është kryer pa aprovimin paraprak të Kuvendit Komunal;
- C1 Në një (1) rast ishte inicuar procedura e prokurimit pa projekt ekzekutues;
- A5 Në një (1) rast kishte vonesë në procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nga komisioni vlerësues;
- A6 Mosrespektimi i kërkesave rregullative për emërimin e ekipit për menaxhimin e kontratës për kontratat e punëve; dhe
- B4 Menaxhimi i kontratave nuk është administruar përmes platformës së prokurimit elektronik (E-prokurimi).

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Glllogocit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Glllogocit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Glllogocit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Glllogocit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Gillogocit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat me probleme më të theksuara të cilat kanë ndikuar në opinionin e auditimit kishin të bënin me klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve dhe nënvlerësimin e obligimeve të papaguara.

Ndërsa, sa i përket mospajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, janë identifikuar mangësi në realizimin e inspektimeve të pronave, vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore dhe në pagesën e faturave, tejkalim i sasive të kontratave me çmim për njësi, rialokim të mjeteve pa miratimet e nevojshme, inicim të procedurave të prokurimit pa projekt ekzekutues, dhe mangësi në zbatimin e procedurave tjera të prokurimit. Gjithashtu nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për inkasimin e mjeteve për të hyrat që i takojnë komunës nga shfrytëzimi i Parkut të Biznesit.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre gjashtë (6) janë rekomandime të reja, pesë (5) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Ligji mbi Ndarjet Buxhetore Nr. 08/L-332 në nenin 15 paragrafi 12 përcakton se, ndarjet buxhetore nga "Rezerva" me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbarimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ.

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Ne identifikuam klasifikim jo adekuate të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë prej 2,341,210€ (në këtë vlerë është i përfshirë vetëm borxhi kryesor). Këto pagesa janë paguar me vendim të gjykatës nga kategoria e investimeve kapitale, mallra dhe shërbime dhe subvencione për zbatimin e kontratës kolektive duke paguar paga dhe shtesa tjera. Komuna

kishte dhënë sqarime në Pasqyra Financiare në lidhje me pagesat e vendimeve gjyqësore nga kontrata kolektive.

Kjo ka ndodhur për shkak të nivelit të lartë të detyrimeve nga kontrata kolektive dhe se komuna nuk kishte bërë planifikim të mjaftueshëm sipas nevojave dhe kërkesave të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

- Ndikimi** Pagesat e realizuara nga kategoria jo-adekuate, shpien në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare Vjetore të komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve janë të mbivlerësuar /nënvlerësuar dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PFV-ve.
- Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë që, me rastin e përgatitjes së buxhetit të merr parasysh kërkesat e ligjit të buxhetit, në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A1 - Nënvlerësim i obligimeve në PFV

- Gjetja** Sipas nenit 17.3 të Rregullores MF nr.01/2017 për Raportim Financiar Vjetor, "Organizatrat Buxhetore duhet t'i raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) për vitin raportues".

Nga vlera e faturës prej 232,373€, janë paguar 119,709€. Bazuar në këtë, rezulton se ka mbetur për pagesë shuma prej 112,664€ e cila nuk ka evidencë se është paguar deri në fund të vitit dhe e njëjta nuk është prezantuar në PFV si obligim.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së koordinimit dhe komunikimit me kohë ndërmjet zyrtarëve përgjegjës, si dhe mungesës së procedurave adekuate të verifikimit të obligimeve para përfshirjes së tyre në PFV.

- Ndikimi** Mos prezantimi i obligimeve ka ndikuar në nënvlerësimin e tyre dhe rrjedhimisht edhe në prezantimin jo të saktë të tyre në PFV.
- Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave një koordinim më efektiv në mes drejtorive në raportimin e faturave të papaguara me qëllim që në PFV të shpaloset vlera e saktë e obligimeve të papaguara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Mosrealizimi i plotë i inspektimit të pronave

Gjetja Sipas nenit 15 të Ligji nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, “Veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzet përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe vetëm kur është e nevojshme për parcela.

Komuna nuk kishte arritur të realizojë nivelin e kërkuar të inspektimeve të pronave sipas kërkesave ligjore. Nga gjithsej 17,605 prona të regjistruara, gjatë vitit 2025 ishin inspektuar vetëm 1,657 prona ose rreth 9% e tyre.

Kjo kishte ndodhur për shkak të fokusimit të ulët të aktiviteteve për verifikim dhe vështirësive teknike në funksionimin e programit të ri të tatimit në pronë.

Ndikimi Mosrealizimi i verifikimeve në nivelin e kërkuar rrit rrezikun që të dhënat për pronat të mos jenë të plota dhe të sakta, duke ndikuar në identifikimin e ndryshimeve në prona dhe rrjedhimisht edhe në llogaritjen dhe inkasimin e drejtë të tatimit në pronë.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikimin e pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale në prona të integrohen në bazën e të dhënave dhe të reflektojnë detyrimin e saktë tatimor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore

Gjetja Neni 17 (pika 1.2) i Ligjit të Ndërtimit thotë: “Leja ndërtimore lëshohet nga organi kompetent brenda (30) ditëve pas pranimit të kërkesës për leje ndërtimore për kategorinë I dhe dyzet e pesë (45) ditë për kategoritë II dhe III”.

Në tre (3) raste kemi vonesa në lëshimin e vendimeve për lejet ndërtimore nga ana e Komunës pas pranimit të kërkesës për leje ndërtimore. Vonesat në lëshimin e lejeve ndërtimore sillen nga 30 deri në 65 ditë.

Kjo kishte ndodhur për arsye të vonesave në kompletimin me kohë të dokumentacionit nga ana e aplikuesve (aplikuesit nuk kishin ofruar projektin zbatues në harmoni me dokumentet e Planifikimit Hapsinor).

Ndikimi Vonesat në lëshimin e lejeve ndërtimore, përveç inkasimit me vonesë të të hyrave, ndikojnë në ligjshmërinë dhe efikasitetin e lëshimit të lejeve ndërtimore.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë që të respektohen afatet për lëshimin e lejeve ndërtimore, në mënyrë që të mundësohet mbledhja me kohë e të hyrave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Realizimi i artikujve të kontratës, jo në përputhje me peshën e përcaktuar në tender**Gjetja**

Bazuar në nenin 54.15 të Rregullores 001/2022 “Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus 30%”.

Te kontrata kornizë me çmim për njësi “Mirembajtja dhe servisi i veturave” kemi identifikuar se realizimi i artikujve me çmim për njësi nuk ishte në përputhje me peshat e përcaktuara në dosjen e tenderit. Vlera totale e kontrates për tre (3) vite ishte 64,200€ e ndarë në pesë (5) pozicione. Në dy (2) pozicione ishte tejkualuar vlera e planifikuar, ku në njërin pozicion tejkualimi ishte 19,796€ (nga 9,630€ të planifikuara ishin realizuar 29,424€), ndërsa në tjetrin 3,561€ (nga 16,692€ ishin realizuar 20,253€), përderisa në pozicionet tjera realizimi ishte më i vogël se sa planifikimi. Duhet theksuar se vlera e kontratës si tërësi nuk ishte tejkualuar.

Tejkualimi dhe pranimi i shërbimeve ka ndodhur si rezultat i mbikëqyrjes së dobët nga ana e menaxherit të kontratës.

Ndikimi

Tejkualimi i shpenzimit të sasive të lejuara sipas peshës rritë rrezikun që oferta e përzgjedhur të mos jetë më e lirë në ekzekutim.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë se menaxheri i kontratës monitoron dhe parandalon tejkualimet e furnizimeve/shërbimeve për çdo pozicion bazuar me peshën që i është dhënë me kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A3 - Vonesa në pagesën e faturave dhe mos prapësim i kërkesës nga përmbaruesi****Gjetja**

Sipas nenit 39 të LMFPP-së Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit përcaktohet se ZKF i Organizatës Buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për OB-në të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim.

Ne identifikuam se:

- Në pesë (5) raste, faturat në vlerë prej 224,348€ ishin paguar me vonesë nga 32 deri në 62 ditë; dhe
- Katër (4) faturat me vlerë prej 37,972€ nga kontrata “Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës” ishin pranuar nga Komuna me 26.11.2025. Pas gjashtë (6) ditëve Komuna ka pranuar urdhërin për përmbarim dhe i njëjti nuk ishte prapësuar nga ana e Komunës përkundër faktit se Komuna ishte brenda afatit prej 30 ditësh. Në fund të muajit dhjetor ishte realizuar pagesa nga Thesari sipas urdhërit përmbarimor duke përfshirë edhe kostot shtesë të përmbarimit dhe interesit prej 407€.

Vonesat në pagesa kanë ndodhur për shkak të kontrolleve jo adekuate në ekzekutimin e pagesave dhe përdorimit të fondeve për pagesa me vendime gjyqësore. Po ashtu, mosprapësimi i kërkesës për përbarim sipas zyrtarëve të komunës nuk ishte bërë me qëllim që të mos rriten më tutje kostot shtesë të përbarimit dhe interesit.

Ndikimi Si pasojë e vonesave në pagesën e faturave, komuna mund të përballet me kosto shtesë të interesit dhe përbarimit. Mos prapësimi i urdhërit përbarimor ka ndikuar në kosto shtesë.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë që obligimet financiare kryhen brenda afatit prej 30 ditëve, (përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për mundësinë e ridestinit të mjeteve) për të shmangur kostot shtesë si pasojë e vonesave në pagesën e faturave. Po ashtu, kur urdhëri përbarimor pranohet para se të kalojë afati prej 30 ditësh nga pranimi i faturës duhet bërë prapësimi i tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A4 - Rialokimi i mjeteve për projekte kapitale pa aprovimin paraprak të Kuvendit Komunal

Gjetja Neni 16, pika 11 e Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 "Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal".

Ne identifikuar dy (2) raste ku janë bërë ndryshime në ndarjet buxhetore ndërmjet projekteve kapitale përmes vendimeve të Kryetarit të Komunës, pa u siguruar aprovimi paraprak i Kuvendit Komunal, siç kërkohet me legjislacionin në fuqi si në vijim:

- Pagesa në vlerë 13,354€ për projektin "Asfaltimi i Rrugës Llapushnik, Poterk dhe Vukoc" është realizuar nga buxheti i projektit "Renovimi i stadionit sintetik Drenas dhe Palestra sportive Hysni Jetullahu"; dhe
- Pagesa në vlerë 4,150€ për projektin "Veturë zyrtare për stafin e qendrës për punë sociale" është realizuar nga buxheti i projektit "Veturë zyrtare".

Pagesat janë autorizuar me vendim nga Kryetari për shkak të mungesës së buxhetit në këto projekte si dhe rrezikimit që këto mjete të merren nga përbaruesi.

Ndikimi Mosrespektimi i procedurave të përcaktuara ligjore për ndryshimet buxhetore dobëson kontrollin dhe mbikëqyrjen e Kuvendit Komunal mbi menaxhimin e buxhetit dhe zvogëlon transparencën në procesin e ekzekutimit të buxhetit.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha transferet dhe rialokimet e mjeteve ndërmjet projekteve buxhetore të marrin aprovimin paraprak të Kuvendit Komunal para se të zbatohen, në mënyrë që të sigurohet respektimi i kërkesave ligjore dhe forcimi i kontrollit mbi menaxhimin e buxhetit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja C1 - Mungesa e projektit ekzekutues

Gjetja Sipas nenit 19.17 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik "Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit".

Aktiviteti i prokurimit Ndërtimi i aneksit të shkollës SHFMU Arif Shala dhe Naim Frashëri, në shumën prej 284,985€ ishte inicuar pa projekt ekzekutues.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së planifikimit të duhur para fillimit të procedurave të prokurimit, duke përfshirë mungesën e hartimit të projektit ekzekutiv për projektet specifike.

Ndikimi Mungesa e projektit ekzekutues mund të shkaktoj vështirësi në realizimin e projekteve duke rritur rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin profesional, ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit forcimin e kontrolleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projektit ekzekutues.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A5 - Vonesa në vlerësim të tenderit**

Gjetja Sipas nenit 40.3 të rregullorës nr.001/2022 KRPP-së konkretisht procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nga komisioni vlerësues, dhe nxjerrja e Njoftimit mbi vendimin e AK nga ZPP, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Në procedurën e prokurimit "Ndërtimi, zgjerimi dhe rikonstruimi i rrjetit të kanalizimit në Drenas - projekt dy vjeçar" në shumën prej 479,451€ vlerësimi i ofertave ishte kryer 74 ditë pas hapjes së ofertave.

Kjo kishte ndodhë si rezultat i angazhimeve në fund të vitit dhe moskujdesit

të mjaftueshëm të stafit të angazhuar në këtë proces vlerësimi.

Ndikimi Vonesat në vlerësim të tenderëve përveç anashkalimit të rregullave kanë ndikuar edhe në vonesat në lidhje të kontratës e rrjedhimisht në shtyrjen e realizimit e projektit në tërësi.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit se vlerësimi i ofertave përfundohet brenda afateve të përcaktuara. Në rastet kur bëhet fjalë për procedura komplekse duhet të shqyrtohen zgjidhjet e nevojshme për të përshpejtuar procesin e vlerësimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mosemërimi i ekipit për menaxhimin e kontratave për punë

Gjetja Sipas nenit 70.20 të Rregullores nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, për kontratat për punë dhe kontratat e projektimit duhet të emërohet Ekipi për Menaxhimin e Kontratës, i përbërë nga profesionistë sipas fushëveprimit të kontratës, ku secilit anëtar i caktohen përgjegjësi specifike, ndërsa njëri nga anëtarët emërohet udhëheqës i ekipit.

Në gjashtë (6) raste të kontratave të punës kemi evidentuar se ishte emëruar vetëm një menaxher i kontratës dhe nuk kishte formuar ekipin për menaxhimin e kontratës, sipas rregullores.

Sipas zyrtarëve përgjegjës, mosemërimi i ekipit për menaxhimin e kontratës kishte ndodhur për shkak të mungesës së stafit të mjaftueshëm profesional për të përbërë ekipet sipas kërkesave të përcaktuara në rregullore.

Ndikimi Mosformimi i ekipit për menaxhimin e kontratës kufizon mbikëqyrjen profesionale të aspekteve të ndryshme të kontratës, rrit rrezikun që punët të mos monitorohen në mënyrë adekuate sipas ekspertizës së nevojshme dhe mund të ndikojë në cilësinë e menaxhimit dhe realizimit të kontratave.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë që për të gjitha kontratat e punëve dhe kontratat e projektimit të emërohet ekipi për menaxhimin e kontratës duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e secilit anëtar dhe udhëheqësin e ekipit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Menaxhimi i kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit

Gjetja Sipas Rregullores nr. 001/2022 të KRPP, konkretisht nenit 70.1 dhe paragrafit 70.24.f, administrimi i kontratave duhet të realizohet përmes platformës së prokurimit elektronik (E-prokurimi). Ky paragraf përcakton se Menaxheri i Kontratës është i obliguar të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mirëmbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhimin e kontratës në sistemin e prokurimit elektronik.

Në nëntë (9) rastet e testuara kemi vërejtur se menaxhimi i kontratave nuk ishte administruar përmes platformës së prokurimit elektronik (E-prokurimi).

Kjo kishte ndodhe si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase ne procesin e menaxhimit të kontratave përmes e-prokurimit.

Ndikimi

Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo efektiv të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë nga të gjithë menaxherët kontratave që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2025 ka shpалosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 5,778,202€. Kjo përbëhet nga tatimi në pronë në vlerë 2,716,657€, nga taksa për ushtrim të veprimtarisë 2,153,576€, nga qiraja nga pronat 888,382€, dhe të tjera në vlerë 19,587€.

Çështja B5 - Mosinkasimi i të arkëtueshmeve nga qiratë e Parkut të Biznesit

Gjetja Sipas Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Drenasit dhe Ministrisë së Tregtisë për menaxhimin e Parkut Industrial, 70% e të hyrave nga qiratë e shfrytëzuesve të parkut i takojnë komunës.

Faturimi i qirave kryhet nga Ministria e Tregtisë dhe të hyrat derdhen në Llogarinë e Vetme të Thesarit. Megjithatë, për shkak të mungesës së një mekanizmi të përcaktuar për transferimin e pjesës që i takon komunës, deri në fund të vitit 2025 nuk janë transferuar të hyrat përkatëse në vlerë prej 837,130€, të cilat komuna i ka evidencuar si llogari të arkëtueshme.

Memorandumi ekzistues nuk ka paraparë një mekanizëm të zbatueshëm financiar për transferimin e të hyrave nga Llogaria e Vetme e Thesarit në buxhetin komunal, ndërsa palët nuk kanë harmonizuar procedurat e nevojshme me Ministrinë e Financave.

Ndikimi Mosrealizimi i transferimit të të hyrave që i takojnë komunës ka rezultuar me akumulimin e llogarive të arkëtueshme, kufizimin e burimeve financiare në dispozicion të komunës dhe pasiguri lidhur me inkasimin e këtyre mjeteve në të ardhmen.

Rekomandimi B5 Kryetari i komunës, në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Ministrinë e Financave, duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për krijimin e një mekanizmi të zbatueshëm ligjor dhe financiar që mundëson transferimin dhe inkasimin e rregullt të të hyrave që i takojnë komunës nga shfrytëzimi i Parkut të Biznesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

Çështja 1 **Mangësi në draft pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese**

Gjetja

Ne kemi identifikuar se Pasqyrat Financiare të Komunës së Drenasit për vitin 2025 të datës 30.01.2025 përmbajnë gabime dhe pasaktësi si dhe mungesë të shpalosjeve dhe si të tilla duhet të përmirësohen (korrigjohen) si në vijim:

- Neni 14.6 Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit tek hyrjet, Te hyrat tatimore dhe te hyrat jo tatimore vlerat sipas buxhetit fillestar duhet të jene të njëjta edhe tek buxheti përfundimtar;
- Te shënimi 2 Paga dhe shtesa Buxheti final nuk është paraqitur i saktë;
- Te shënimi 3 Mallra dhe Shërbime, Buxheti final nuk është paraqitur i saktë; dhe
- Te shënimi 11 Grantet e përcaktuara të donatoreve nuk është paraqitur vlera e saktë
- Te neni 19.3.1 Pasururitë kapitale (me vlerë mbi 1000Euro) të vendosen nën totalin e sakta për vitin 2023.

Veprimi i kërkuar

Menaxhmentit të entitetit i është kërkuar që të ndërmarrë veprime për t'i korrigjuar Pasqyrat Financiare Vjetore.

Rezultati

Menaxhmenti ka bërë korrigjimet për çështjet që i kemi sugjeruar. Këto gabime kanë rezultuar për shkak të kontrolleve të brendshme jo të mjaftueshme, prandaj ne ju tërheqim vëmendjen se nëse këto gabime përsëriten në PVF e vitit vijues atëherë çështja do të rezultojë me rekomandim në raportin e auditimit

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	22,133,550	24,257,185	23,503,186	23,271,466	21,603,045
Grante Qeveritare - Buxheti	20,197,083	21,074,389	20,608,790	19,245,501	18,024,090
Të bartura nga viti i kaluar	0	953,494	842,743	1,106,748	1,597,939
Të hyrat vetanake	1,936,467	1,936,467	1,799,614	1,800,834	1,580,064
Donacionet vendore	0	2,213	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	290,622	252,039	1,118,383	400,953

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 2,123,635€. Kjo rritje ishte nga granditë e Qeverisë prej 877,306€, nga bartja e të hyrave vetjake nga viti paraprak prej 953,494€, si dhe prej donacioneve 292,835€.

Në vitin 2025 komuna ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 23,503,186€, me një rritje 3% në krahasim me vitin 2024. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	22,133,550	24,257,185	23,503,186	23,271,466	21,603,045
Pagat dhe mëditjet	11,497,909	12,375,215	12,373,320	11,851,852	10,909,740
Mallrat dhe shërbimet	2,622,703	2,772,933	2,428,073	2,502,429	2,426,270
Komunalitë	346,749	346,823	331,868	334,770	315,379
Subvencionet dhe transferet	594,000	599,448	587,649	502,992	458,415
Investimet Kapitale	6,956,940	8,162,765	7,782,276	8,079,423	7,493,242
Rezervat	115,249	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 877,306€. Ky ndryshim ishte rezultat i vendimit të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë 1,367,253€ (për rritje të koeficientit të pagave). Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte pothuajse 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 150,230€. Rritja vjen nga granti i qeverisë prej 105,249, bartja e të hyrave vetjake nga viti paraprak prej 34,981€ dhe nga të hyrat vetanake prej 10,000€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte rreth 88%;
- Buxheti final për shpenzime komunale ishte rritur për 74€ nga bartja e të hyrave vetjake nga viti paraprak. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte rreth 96%;
- Buxheti final për subvencione ishte rritur për 5,448€ nga bartja e të hyrave vetjake nga viti paraprak. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 98%; dhe
- Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,205,825€. Rritja vjen nga bartja e të hyrave vetjake nga viti paraprak prej 912,990€ dhe nga donacionet 292,835€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte rreth 95%. Shpenzimi nga kjo kategori ndër tjerash kanë të bëjë me pagesat e bëra për projektet kapitale si për ndërtimin e rrugëve lokale, rregullimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve, zgjerimin dhe ndërtimin e sheshit, fushave sportive etj.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2025 ishin 1,936,467€, përderisa ishin realizuar 1,677,854€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, participimet, të hyrat nga qiraja etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	1,936,467	1,936,467	1,677,854	1,701,663	1,982,661
Të hyrat tatimore	855,800	855,800	487,186	383,330	927,166
Të hyrat jo tatimore	1,080,667	1,080,667	1,190,102	1,317,488	1,051,559
Të hyrat tjera	0	0	566	845	3,936

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 ka rezultuar me 11 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, pesë (5) rekomandime janë zbatuar, pesë (5) rekomandime nuk janë zbatuar dhe një (1) është pjesërisht i zbatuar siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontroleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.	Nga testimet tona nuk janë identifikuar mangësi në këtë fushë.	I zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që të respektohen afatet ligjore për lëshimin e lejeve ndërtimore, duke forcuar kontrollin e brendshëm dhe mbikëqyrjen mbi trajtimin e kërkesave, në mënyrë që të mundësohet mbledhja me kohë e të hyrave.	Edhe këtë vit ka vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se menaxhimi i kontratës nga menaxheri i kontratës bëhet në pajtim me kërkesat ligjore, në mënyrë që kontrata publike kornizë me çmim për njësi të realizohet në pajtueshmëri të plotë me peshën e përcaktuar në dosjen e tenderit dhe pranimi, pagesa e shërbimeve të bëhet sipas shërbimeve reale të ndodhura.	Nuk është implementuar rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë në procesin e vlerësimit të ofertave përkatëse dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen nga zyrtarët e prokurimit para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.	Nga testimet tona nuk janë identifikuar mangësi në këtë fushë.	I zbatuar
5.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se raportet rregullta gjashtë (6) mujore të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.	Nuk janë identifikuar raste të ngjashme, dhe raportet përmbajnë pjesën e monitorimit.	I zbatuar
6.	Të hyrat	Kryetari duhet të marrë veprime shtesë për të siguruar se janë bërë korrigjimet e nevojshme në bazën e të dhënave të tatimit në pronë, në mënyrë që zbritja për vendbanim parësor të bëhet vetëm për personat fizik të cilët janë të regjistruar me numër personal dhe kanë deklaruar në komunë se objekti shërben si vendbanim parësor.	Nga testimet tona nuk janë identifikuar mangësi të ngjashme në fushën e tatimit në pronë.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Edhe në këtë vit komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve, për shkak kontratës kolektive.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Investimet kapitale	Kryetari të sigurojë forcimin e kontrolleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Pavarsisht progresit edhe këtë vit ka prokurime në mungesë të projekteve ekzekutive.	Pjesërisht i zbatuar

9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Edhe këtë vit janë identifikuar mangësi në këtë fushë.	Nuk ka filluar zbatim
10.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat, si dhe zbatimin e drejtë të kontroleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale sipas klasifikimit kontabël.	Është implementuar rekomandimi.	I zbatuar
11.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në inkasimin e llogarive të arkëtueshme, duke mos përjashtuar edhe masat juridike.	Nuk janë ndërmarrë veprime për adresimin e rekomandimit.	Nuk ka filluar zbatim

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Alban Beka, Udhëheqës i ekipit



Xhevat Hasolli, Anëtar i ekipit



Valon Halimi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	<p>Komuna ka hartuar dhe planifikuar buxhetin në përputhje me Qarkoren Buxhetore të nxjerrë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), duke pasur parasysh se Ligji për Ndarjet Buxhetore miratohet në një fazë të mëvonshme ku edhe percakohen procedurat e rialokimeve. Në kuadër të këtij planifikimi, janë paraparë mjete edhe në kategorinë e rezervës për mbulimin e detyrimeve kontingjente, përfshirë vendimet gjyqësore dhe përmbare.</p> <p>Megjithatë, duke qenë se, sipas udhëzimeve të MFPT-së, rezerva buxhetore planifikohet brenda kufirit të përgjithshëm buxhetor të organizatës buxhetore, ka qenë e pamundur të sigurohen mjete të mjaftueshme për mbulimin e plotë të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore dhe përmbare. Kjo për shkak se komuna përballlet me obligime të konsiderueshme të bartura edhe nga vitet paraprake, të cilat vetëm nga viti 2024 arrinin në shumën prej 2,488,200 euro, dhe të cilat vazhduan të rriten si rezultat i vendimeve të reja gjyqësore dhe përmbare (kontratave kolektive). Njëkohësisht, gjatë procesit të planifikimit buxhetor, prioritet u është dhënë obligimeve kontraktuale dhe sigurimit të funksionimit të rregullt të shërbimeve komunale, në mënyrë që të mos cenohet ofrimi i shërbimeve esenciale për qytetarët. Sa i përket ndikimit në Pasqyrat Financiare Vjetore, komuna ka dhënë shënime shpjeguese</p>	<p>Ne kemi trajtuar klasifikimin e kategorive ekonomike të prezantuara në pasqyrat financiare të Komunës, nga buxheti i së cilës janë realizuar pagesat. Me këtë rast është konstatuar se shpenzimet nuk ishin klasifikuar në përputhje me planin kontabël.</p> <p>Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.</p>

përkatëse, duke paraqitur për secilën kategori ekonomike vlerën e shpenzimeve të realizuara përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbartimeve, me qëllim të sigurimit të informimit të plotë dhe transparent për shfrytëzuesit e pasqyrave financiare.

Prandaj, konsiderojmë se situata e paraqitur lidhet kryesisht me kufizimet buxhetore dhe nivelin e lartë të detyrimeve si pasojë e kontratave kolektive, e jo me mungesë të planifikimit buxhetor apo të transparencës financiare nga ana e komunës.

Bashkëngjitur shkresa e dorezuar në MFPT si dëshmi e planifikimit të "Rezerves",

Përkundër faktit se këtë çështje e kemi diskutuar në secilin takim, konsiderojmë se zbatimi i nenit 15 të Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore, në formën e paraparë, paraqet vështirësi edhe nga aspekti teknik dhe procedural. Kjo për shkak se, pas pranimit të njoftimit nga MFPT për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe nxjerrjes së menjëhershme të vendimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ, procedura për transferimin e mjeteve nga rezerva në kategorinë përkatëse të shpenzimeve kërkon veprime shtesë nga Departamenti i Buxhetit dhe më pas alokimin e mjeteve nga Thesari. Këto procedura zakonisht kërkojnë më shumë kohë sesa afati që i jepet komunës nga Thesari, i cili në shumicën e rasteve ishte vetëm dy ditë për propozimin e linjave buxhetore për ekzekutimin e pagesave.

<p>Vonesa në pagesën e faturave dhe mos prapësim i kërkesës nga përmbaruesi</p>	<p>Obligimi financiar ndaj kontraktuesit ka qenë i pranuar si obligim i rregullt kontraktual. Për rrjedhojë, paraqitja e prapësimit nuk do të ndikonte në shmangien e obligimit apo të kostove shtesë, por do të kishte vetëm efekt në zvarritjen e procedurës dhe në rritjen e shpenzimeve procedural akoma më të mëdha, duke pasur parasysh se propozimi është iniciuar në dhjetor 2025 dhe në atë periudhë nuk e kishim të aprovuar as buxhetin i Republikës së Kosovës për vitin 2026, i cili u miratuar në mars 2026. Prandaj, moskundërshtimi i propozimit për përmbarim kanë qenë në funksion të administrimit racional të mjeteve publike dhe në përputhje me parimet e ekonomizimit procedural, duke shmangur krijimin e shpenzimeve shtesë për Buxhetin e Komunës.</p>	<p>Arsyetimet e ofruara nga Komuna janë të përfshira te gjetja.</p> <p>Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.</p>
---	--	---

<p>Rialokimi i mjeteve për projekte kapitale pa aprovimin paraprak të Kuvendit Komunal</p>	<p>Furnizimi me veturë zyrtare për stafin e Qendrës për Punë Sociale ishte planifikuar dhe buxhetuar në buxhetin e vitit 2024. Për arsye procedurale të kontratës përmes AQP-së, periudha e realizimit ishte dhënë deri në vitin 2025. Në buxhetin e vitit 2025, i cili ishte miratuar paraprakisht (shtator 2024), projekti për vetura zyrtare ishte planifikuar në nënprogramin e Administratës Komunale, ndërsa obligimi i mbetur është ekzekutuar në kodin përkatës për vetura zyrtare në kuadër të buxhetit të aprovuar të OB-së. Po ashtu, pagesa për projektin e asfaltimit të rrugës Llapushnik-Poterk-Vukoc është ekzekutuar me qëllim shmangien e krijimit të shpenzimeve shtesë për buxhetin e Komunës nga procedurat e ekzekutimit përmbarimor, duke u shmangur një situatë që do të mund të rrezikonte edhe funksionimin e shërbimeve vitale, si furnizimi me barna dhe furnizimi me energji elektrike për institucionet komunale dhe në pamundësi të zgjidhjeve tjera ku tashme nga vendimet përmbarimore që ishin ekzekutuar dhe ato në proces të ekzekutimit rrezikoheshin shërbimet vitale.</p>	<p>Arsyetimet e ofruara nga Komuna janë të përfshira te gjetja.</p> <p>Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.</p>
--	--	---

REPUBLIKA E KOSOVËS
MUNICIPALITY OF GLOGOC
01 Nr. 400/01- 23608
19/06/2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Glogocit, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet, ndërsa, komentet dhe vlerësimet tona lidhur me çështjet B1, A3 dhe A4 i bashkëngjiten këtij konfirmimi.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës

Data: 18. Qershor, 2026



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.